- Për kontrata me institucionet shtetërore duhet të paraqitet kontrata dhe vërtetime të lëshuara, ose faturat tatimore të shitjes. *Kontraten e Siper marrjes, Formular Vleresimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9 shoqëruar me Aktin e Kolaudit, Certifikatën e marrjes në dorezim dhe Situacionin përfundimtar të objektit.*

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3/1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë dhe paraqesë **Licenca profesionale** për aktivitetin që ushtron si më poshtë :

Për realizimin e zërave të riparimeve dhe shërbimeve, objekt i kontratës, Operatori Ekonomik duhet të jetë i paisur me liçense profesionale, (Referuar VKM nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, sipas kategorive të mëposhtme:

- a) NS - 1 A (Punime për prishjen e ndertimeve)
- b) NS - 12 A (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit),
- c) NS - 14 A (Impiante të brendshme elektrike, etj).
- d) NS - 4 A (Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to etj).

2.3/2 Operatori ekonomik ofertues, duhet të jetë i certifikuar dhe paraqesë Çertifikata kualifikimi të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë :

- 1) Çertifikatën për sistemin e menaxhimit të cilësive **ISO 9001:2015** ose ekuivalente
- 2) Çertifikatën për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë **OHSAS 45001:2018** ose ekuivalente
- 3) Çertifikatë për sistemin e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001:2015** ose ekuivalente
- 4) Çertifikatë **PAS 99:2012** mbi “*Sistemi i menaxhimit të integruar* ” ose ekuivalente
- 5) Çertifikatën **ISO 50001:2018**, lidhur me sistemin e menaxhimit të energjisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme
- 6) Çertifikatën **3834-2 : 2006** Për Sistemin e Menaxhimit të Cilësive në Saldim
- 7) Çertifikatën **27001 : 2013** Për Menaxhimin e sigurisë së Informacionit
- 8) Çertifikatën **8000:2014** Për Sistemin e Menaxhimit të Përgjegjësisë Shoqërore

Çertifikatat e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje të noterizuar). BOE (bashkimi i operatorëve ekonomik) duhet të plotësojë të njëjtat kushte.

2.3/3 Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje mjedisi e tipit C, Kodi III.1.A, **Riparim dhe Mirembajtje për paisje ngrohje - ftohje.**

2.3/4 Operatori ekonomik duhet të ketë drejtues teknik si më poshtë:

- | | |
|----------------|---------|
| ➤ Ing.Mekanik | 1 (nje) |
| ➤ Ing.Elektrik | 1 (nje) |

- Ing.Ndertimi 1 (nje)
- Punonjes i trajnuar si auditor per sigurimin dhe kontrollin e cilesise 1 (nje)

Drejtuesit teknik te Operatorit ekonomik duhet te jene **te certifikuar për "Sigurimin teknik"**, vërtetuar me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik.

Operatori ekonomik duhet të kete Ing.Mekanik te certifikuar si Auditues Energjie .

Si dhe te kene me kontrate pune te vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates ose ne stafin e tij, si me poshte :

- Inxhinier elektronik ose informatik 1(nje)
- Inxhinier mekatronik i certifikuar nga prodhuesi ose distributori per paisjet HVAC, i cili te figuroje ne listepagesat e shoqerise per 6 mujorin e fundit 1 (nje)

2.3/5 Shoqeria duhet te kete ne stafin e saj specialiste ndertimi te certifikuar sipas profesioneve si me poshte:

- Specialist per sistem ngrohje ftohje 4 (kater)
- Specialist per punime elektrike 2 (dy)
- Specialist Elektromekanik 1 (nje)
- Specialist Mekanik 2 (dy)
- Specialist per punime hidraulike 1 (nje)
- Specialist Saldator 2 (dy)
- Specialist per punime bojatisje 1 (nje)
- Specialist per punime gipsi 2 (dy)
- Specialiste per punime ne lartesi 2 (dy)
- Ekspert zjarrfikes te certifikuar 1 (nje)

Për ekspertin zjarrfikës certifikata e ekspertit zjarrëfikës si dhe Kontrata e punes (e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te punimeve).

- Operatori ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit ose me kontrate pune (me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt) **2(dy) punonjes te certifikuar/te trajnuar per te kryer punime ne lartesi**, te leshuara nga Institucione te certifikuara/akredituara ne Shqiperi ose tek ato nderkombetare.
- Operatori ekonomik duhet te kete ne perberje te stafit ose me kontrate pune (me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt) **1 (nje) punonjes certifikuar nga organet kompetente për “Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit të Punëtorëve në punë”**.

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë **1 (nje) mjek** ndërmarrjeje të punësuar, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003. *Kjo pike do të vërtetohet me paraqitjen e a) Licensës, b) Kontratës së Punës së mjekut, si dhe te jete i rregjistruar ne listepagesa per periudhen Maj 2019 – Shtator 2019*

Per specialistet e kerkuar me siper te paraqiten *deshmi/certifikate ose cdo dokument tjeter qe verteton kualifikimin e tij.*

- a- Te gjithë punonjesit e kerkuar me siper sipas pikes 2.3/5 te jene te shoqeruar me deshmi/certifikate/diplome, kontrata pune si dhe te figurojne ne listepagesa per periudhen **Maj 2020 – Tetor 2020**
- b- Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi, ing. elektrik, ing.mekanik) duhet te jene drejtues teknike ne licensen e shoqerise si dhe te figurojne ne listepagesat per **Maj 2020 – Tetor 2020.**
- c- Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate nga administratori i shoqerise pjesemarrese ne kete prokurim, qe stafi i inxhinierëve, te kerkuar me siper, jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate dhe nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera.
- d- Deklarate nga administratori i shoqerise per listen e stafit qe do te drejtoje punimet, ku te cilesohen detyra e secilit.
- e- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar per mallrat e ofruara. Në rastin e autorizimin te lëshuar nga distributori, duhet të paraqitet edhe autorizmi apo marrëveshja e prodhuesit për këtë të fundit. Këto dokumente duhen ne formën origjinale ose kopje e njehësuar me origjinalin, i përkthyer dhe i noteruar. Cdo dokument i leshuar nga prodhuesi duhet të përmbajë të dhëna të sakta si email, telefon në rast verifikimi nga ana e Autoritetit Kontraktor
- f- OE duhet te kete (dy) specialistë të çertifikuar për produktet e kondicionimit që ofron. Për këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqes çertifikatë/dëshmi që vërteton kualifikimin e tyre për produktin e ofruar.
- g- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se pajisjet e ofruara prej tij në këtë procedurë janë origjinale nga prodhuesi, si dhe merrë përsipër furnizimin dhe instalimin e produkteve të ofertuara.

Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te kryeje te gjithë verifikimet e nevojshme per te vertetuar deklarimin e mesiperm.

2.3/6 Operatori ekonomik duhet te një punësim mesatar per periudhen **Maj 2020 – Tetor 2020**, i te pakten **20 personave**, duke përfshirë stafin e përhershëm:

- *Kjo pike dokumentohet me vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

2.3/6 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike si më poshtë vijon:

Nr.	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion (kapaciteti total mbajtës deri ne 3.5 ton)	cope	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion me vinc	cope	1	Në pronësi ose me qera
3	Shkalle Alumini per punime ne lartesi deri 3 m	cope	3	Në pronësi ose me qera
4	Saldatrice	Cope	1	Në pronësi ose me qera

Kokore minimumi 20 cope

Rripa sigurimi për punime në lartësi minimumi 4 cope

Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 cope

Jelek pune 20 cope

Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 cope

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë formularin sipas shtojcës 9 të DST dhe dokumentat e mëposhtme:

- i. *Për pajisjet, nëse jane në pronësi, duhet te paraqitet fatura tatimore e shitjes apo akti i zhdoganimit.*
- ii. *Për pajisjen, nëse eshte me qera, duhet te paraqitet kontrata e qirasë dhe fatura tatimore e shitjes apo akti i zhdoganimit.*
- iii. *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë ne pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.*
- iv. *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira, duhet të paraqitet kontrata e qirase, dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.*
- v. *Për mjetet dhe pajisjet që janë me qera, kontrata e qirasë duhet të jetë e vlefshme, për periudhën nga data e hapjes së ofertave deri në zbatimin e plotë të kontratës.*

e)

f) **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet, pajisjet dhe dokumentacionet teknike të deklaruara më sipër**

g)

h) Ne rast se oferta paraqitet nga bashkim operatorësh ekonomike, Shtojca nr.12 e DST (Kriteret e veçanta të kualifikimit) duhet të plotësohet në përputhje me nenin 74 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Sistemi i Ngrohjes dhe Kondicionimit

1.1 Hyrje

Ambientet janë të përbërë nga zona me tipologji të njëjtë, në të cilat ushtrohen aktivitete që kanë të njëjtin qëllim të përbashkët për sa i përket sigurimit të një komoditeti.

Këto kërkesa janë paraparë në proporcion me standartet e jetesës.

1.2 Konditat e projektimit

Konditat e komfortit termoigrometrik (mirëqënia fiziologjike) që mund të sigurojmë brenda ambienteve janë në varësi të destinacionit të përdorimit të ambienteve. Të dhënat e mëposhtëme janë përdorur si referenca për projektin.

Vendndodhja

Tiranë

Gjersia gjeografike

42 °

Për periudhën e ngrohjes - Dimër

Temperatura e brendshme llogaritëse	20 - 24°C
Lagështia relative e brendshme	40–50%
Temperatura e jashtme llogaritëse	0°C

Për periudhën e freskimit – Verë

Temperatura e brendshme llogaritëse	25 - 27°C
Lagështia relative e brendshme	50–60%
Temperatura max. e muajit të nxehtë	42°C
Temperatura mesatare e muajit të nxehtë	35°C
Lagështia relative mes. e muajit të nxehtë	55 %

Sistemi i ngrohjes/ftohjes së ambienteve është planifikuar të punojë për mposhtjen e humbjeve të ngarkesave termike me anë të kasetave të montuara në tavan kurse për qarkullimin e ajrit të ambientit dhe ajër të freskët është vendosur të bëhet nëpërmjet njësisë së trajtimit të ajrit. Burimi i energjisë do të sigurohet nga makineritë e jashtme (kompresorët e gazit) të cilat do të jenë version pompe nxehtësie me Inverter e tipit VRF.

1.3 Përzgjedhja e sistemit VRF (Variable Refrigerant Flow) dhe tipologjia

Karakteristikat e sistemit të përzgjedhur janë parashikuar në vartësi të kriterëve të mëposhtëm:

- Fleksibilitet gjatë gjithë kohës së shfrytëzimit që do të thotë që kapacitet e sistemit të sigurojnë performancë variabile gjatë ditës dhe në sezone të ndryshme.
- Fleksibilitet në kapacitet e terminaleve në ambientet e destinuara.
- Te jete i afte te siguroje kondita në përputhje me ato të parashikuara në kriteret e projektimit për kosto te ulet përdorimi dhe mirëmbajtje.

Tipologjia e përzgjedhur e sistemit do te jete “e kombinuar ndermjet ajrit te riqarkullueshem dhe ajrit te fresket nga jashte ” i centralizuar nga vete fakti se te gjithë ambientet punojne njekohesisht gjate tere orarit te punes, pra sistemi i përzgjedhur eshte nje sistem VRF me inverter, qe ushqehen te gjithë paisjet nepermjet ypsylonave lidhes.

Ky sistem siguron kërkesat e ambienteve për energji termike (ngrohje, ftohje, ajër të fresket). Kontrolli zonal do të sigurojë dhenien, ndërprerjen si dhe modulimin e kërkesës për energji termike në funksion të ngarkesave termike, në funksion të fashave orare të përdorimit gjatë 12 orëve, të ambienteve me vecori tipike përdorimi, duke realizuar kështu përdorimin eficient të konsumit të energjisë.

Impianti do të përbehet nga këto komponente kryesore:

- Njesia e jashtme – Kompresor me zgjerim direkt VRF, version pompe nxehtësie me ALL DC Inverter;
- Njesite e brendshme
- Ypsylonat e shpendarjes;
- Tubacionet e bakrit
- Tubacionet e kondesimit
- Furnizimi me energji dhe komunikim
- Kontrolli i temperaturave të ambienteve do të sigurohet nepermjet pulteve autonome të ambienteve që komandojnë njesite e brendshme respektive.

Në zgjidhjen teknike grupi i punës ka vendosur që për të gjitha katet e zyrave të bëhet vendosja e sistemit të kondicionimit qendror të tipit VRF.

Sistemi VRF i projektuar për të siguruar ftohjen dhe ngrohjen është i tipit ajër -ajër.

Sistemi është i përbërë nga njësia e jashtme pompë nxehtësie me kontroll inverter dhe nga një numër njësish të brendshme të cilat lidhen me njëra tjetrën dhe furnizohen të gjitha nga njësia e jashtme. Duke qenë se ky sistem lejon përdorimin e njësive të brendshme të të gjitha llojeve (si mural edhe tavanor) në ambientet e zyrave do të vendosen njësi të brendshme murale.

Ky sistem përdor gazin freon ekologjik të llojit R410A i cili është shumë eficient nga pikëpamja termodinamike.

Njesia e jashtme shpërndan ftohesin tek njesite e brendshme nepermjet tubash bakri të dedikuar, të cilat janë të llojit të vecantë, të afte për të punuar edhe në vlera të larta të presionit (40 bar), veçanërisht për ftohesin R410A.

Sistemi qendror i kondicionimit do të lidhet në rrjetin tre fazor të instaluar në institucion dhe është All DC inverter dhe i klases A++ energjitike.

Pajisjet e brendshme murale janë të tipit ALL DC Inverter VRF. Njesite e brendshme janë të pajisura me pompe kondensimi, panel dekorativ me grilen e thithjes me filter dhe me fletet e hedhjes së ajrit, si dhe pultin e komandimit i cili ka si funksione kryesore:

Kontrollin e temperatures

Programimin e kohes (timer)

Diagnostikimin me ane te parametrave

Display te alarmit dhe kodit error

Indikacion te pastrimit te filtrit te ajrit.

Sistemi VRF (**Variable Refrigerant Flow**) shfaq karakteristika shume te mira, lidhur me shpejtesine e instalimit, zvogelimin e pjeses mirembajtese, pasi numri i nyjeve te valvolave eshte i reduktuar vetem ne pajisje dhe terminale.

Pajisjet e jashtme jane te tipit outdoor, ALL DC Inverter VRF, klasa A++ dhe jane te pajisura me kompresor inverter, ventilator elikoidal inverter, me trup pune gazin R410A, me mbrojtje kundra ngrirjes dhe kontroll te temperatures se freonit ne dergim.

Temperatura per funksionimin e pajisjes se jashteme:

Ne ciklin e ftohjes eshte intervali -5°C deri ne + 53°C

Ne ciklin e ngrohjes eshte intervali -20°C deri ne + 24°C

1.4 Kontrolli zonal ose qendror

Ky kontroll do te siguroje dhenien, nderprerjen si dhe modulimin e kerkeses per energji termike ne funksion te ngarkesave termike, ne funksion te fashave orare te perdorimit gjate oreve te punes ne ambientet me vecori tipike perdorimi, duke realizuar keshtu perdorimin eficient te konsumit te energjise. Te gjitha terminalet do te kontrollohen nepermjet termostateve te ambienteve. Nderkohe sistemi i centralizuar na lejon te menaxhojme te gjitha sherbimet dhe sistemin ne teresi.

Funksionet esenciale qe mund te realizoje sistemi do te jene:

- Nisja dhe ndalimi i funksionimit te pajisjeve ne baze te nje programi kohor te paravendosur;
- Kontrolli i parametrave te parashikuar;
- Transmetimin e informacioneve per demtime te mundshme ose funksionimin jo normal te pajisjeve;

- Program mirembajtje.

1.5 Makineri dhe paisje

Sistemi i përdorur për ngrohjen/kondicionimin e objektit “Zyrat e ARRSH”, parashikohet të realizohet nepermjet sistemit VRF. Ky sistemi është me efikasitet shumë të lartë në kursimin e energjisë dhe të hapsirave që zë. Sistemi inovativ VRF me inverter siguron performancë të lartë në ambiente sipas kërkesave të personave që e popullojnë ato. Sistemi i parashikuar është i lehtë në instalim, përdorim, mirembajtje dhe siguron një kosto të ulët përdorimi.

Paisjet e përdorura janë VRF me inverter me karakteristika teknike si më poshtë:

a- Njesi e jashtme VRF tipi Pompe Nxehtesie

Paisja e jashtme është një paisje version pompe nxehtesie me inverter, e cila suporton lidhjen deri në 64 paisje në seri.

Fleksibiliteti i këtij sistemi është në përdorimin e gjatësisë me të lartë të një paisjeje të brendshme.

Keto pajisje punojnë me ekspansion direkt në variantin pompe nxehtesie, lidhen në seri me njëra tjetren me anë të Y-ypsyronave lidhës.

Më poshtë jepen karakteristikat teknike të paisjes:

Njesi e jashtme VRF, kapaciteti në ftohje 40kW, kapaciteti në ngrohje 45kW

Pershkrimi	Njesia	Vlera
Fuqia ftohëse	kw	50.4
Fuqia ngrohëse	kw	56.5
Konsumi i energjisë në ftohje	kw	12.2
Konsumi i energjisë në ngrohje	kw	12.8
EER	kw/kw	4,13
COP	kw/kw	4.41
Konsumi aktual në ftohje	A	19.0
Konsumi aktual në ngrohje	A	19.8

Furnizimi me energji elektrike	380~415V 3Ph~50/60Hz	
Nr. maksimumi i U.I.		29
Prurja e ajrit	m³/h	11400
Presioni maksimal	dB(A)	64
Presioni minimal	dB(A)	45
Gazi	Tipi	R410a
Sasia e furnizimit me gaz	kg	5.9+6.7
Diametri i tubit te gazit	mm	28.6
Diametri i tubit te lengut	mm	15.9
Diametri i tubit te vajit	mm	9.52

b-Njesi e brendshme VRF tipi mural

**Njesi e brendshme VRF,
9000Btu/h**

Pershkrimi		Njesia	Vlera
Kapaciteti Nominal	Ftohje	kw	2.8
Kapaciteti Nominal	Ftohje	Btu/h	9500
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	kw	3.2
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	Btu/h	10900
Fuqia e dizenuar	Fuqia e dizenuar	kw	2.8/3.2

Konsumi Energjise	Ftohje	w	50
Konsumi Energjise	Ngrohje	w	50
Specifikimet elektrike	220-240 V 1Ph- 50/60 Hz		
Prurja e Ajrit		m³/h	500/420/350
Niveli i Zhurmave		dB(A)	38/34/30
Diametri i Tubave		mm	Ø9.52
Diametri i Tubave		inch	3/8"
Diametri i Tubave		mm	Ø6.35
Diametri i Tubave		inch	1/4"
Tubi Shkarkimit	Diametri Brendshem	mm	Ø20
Tubi Shkarkimit	Spesori	mm	1.5
Lloji agregatit	Gaz	Ekologjik	R410a

**Njesi e brendshme VRF,
12000Btu/h**

Pershkrimi		Njesia	Vlera
Kapaciteti Nominal	Ftohje	kw	3.6
Kapaciteti Nominal	Ftohje	Btu/h	12200
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	kw	4.0
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	Btu/h	13600
Kapaciteti Nominal	Fuqia e dizenuar	kw	3.6/4.0
Konsumi Energjise	Ftohje	w	60

Konsumi Energjise	Ngrohje	w	60
Specifikimet elektrike	220-240 V 1Ph- 50/60 Hz		
Prurja e Ajrit		m³/h	630/550/480
Niveli i Zhurmave		dB(A)	44/41/38
Diametri i Tubave		mm	Ø12.70
Diametri i Tubave		inch	1/2"
Diametri i Tubave		mm	Ø6.35
Diametri i Tubave		inch	1/4"
Tubi Shkarkimit	Diametri Brendshem	mm	Ø20
Tubi Shkarkimit	Spesori	mm	1.5
Lloji agregatit	Gaz	Ekologjik	R410a

**Njesi e brendshme VRF,
18000Btu/h**

Pershkrimi		Njesia	Vlera
Kapaciteti Nominal	Ftohje	kw	5.6
Kapaciteti Nominal	Ftohje	Btu/h	18000
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	kw	6.3
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	Btu/h	21500
Kapaciteti Nominal	Fuqia e dizenuar	kw	5.6/6.3
Konsumi Energjise	Ftohje	w	70

Konsumi Energjise	Ngrohje	w	70
Specifikimet elektrike	220-240 V 1Ph- 50/60 Hz		
Prurja e Ajrit		m³/h	750/600/500
Niveli i Zhurmave		dB(A)	44/41/38
Diametri i Tubave		mm	Ø15.87
Diametri i Tubave		inch	5/8"
Diametri i Tubave		mm	Ø9.52
Diametri i Tubave		inch	3/8"
Tubi Shkarkimit	Diametri Brendshem	mm	Ø30
Tubi Shkarkimit	Spesori	mm	1.5
Lloji agregatit	Gaz	Ekologjik	R410a

**Njesi e brendshme VRF,
24000Btu/h**

Pershkrimi		Njesia	Vlera
Kapaciteti Nominal	Ftohje	kw	7.1
Kapaciteti Nominal	Ftohje	Btu/h	24000
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	kw	7.5
Kapaciteti Nominal	Ngrohje	Btu/h	25500
Kapaciteti Nominal	Fuqia e dizenuar	kw	7.1/7.5
Konsumi Energjise	Ftohje	w	70
Konsumi Energjise	Ngrohje	w	70
Specifikimet elektrike	220-240 V 1Ph- 50/60 Hz		

Prurja e Ajrit		m ³ /h	750/600/500
Niveli i Zhurmave		dB(A)	44/41/38
Diametri i Tubave		mm	Ø15.87
Diametri i Tubave		inch	5/8"
Diametri i Tubave		mm	Ø9.52
Diametri i Tubave		inch	3/8"
Tubi Shkarkimit	Diametri Brendshem	mm	Ø30
Tubi Shkarkimit	Spesori	mm	1.5
Lloji agregatit	Gaz	Ekologjik	R410a

c- Lidhjet me pajisjet e jashtme dhe te brendshme:

Degezues Y



Këto pajisje shërbejnë për shpërndarjen e gazit nëpër paisje, kanë formën e ypsilonit dhe shërbejnë që jo vetëm të shpërndajnë gazin nëpër kolektor por bejnë dhe lidhjen e këtyre kolektorëve me paisjen e jashtme. Sipas standartit UNI EN 378. Degezuesit do te termoizolohen sipas standartit.

d- Tuba bakri, për R410A, dhe termoizolim me spesor + Rakorderi

Tubot e bakrit Cu për agentë ftohës R410A janë të destinuara për përdorim kondicionimi dhe do të furnizohen së bashku me pajisjet, ndërsa rakorderitë do të jenë prej bronzi. Për tubacionet rulon plotësohet standarti EN 12735-1, me nivel pastërtie të brendshme në përputhje me standartin ASTM B280. Ndërsa tubacionet e drejta përmbushin standartin EN 1057. Spesori i tubave nuk

duhet të jetë me i vogël se 1-1.25 mm. Spesori i termoizolimit nuk duhet të jetë me i vogël se 9 mm për instalime të brendshme dhe jo me i vogël se 13 mm për instalime të jashtme.

Lidhjet do të realizohen me saldim ose me shtrëngim.

Standardi: UNI EN 12735-1;

Presioni i çarjes: 18.9 - 93.17 MPa (në varësi të tubit);

Presioni i punës: 4.53 - 23.29 MPa (në varësi të tubit);

Trupi i punës: R410A.

Lënda e parë e bakrit duhet të përmbushë standartin EN12735-1, me një nivel pastërtie të brendshme sipas standartit ASTM B280.

Tubat duhet të jenë të izoluar me një veshje speciale prej polietileni me densitet të ulët me qeliza të mbyllura.

Tubacionet me shufra të drejta

Lënda e parë e bakrit duhet të përmbushë standartin EN 1057, DPR 1095 dhe cilësinë sipas EN ISO 9001:2008. Duhet të jetë i shënuar CE, siç kërkohej nga 89/106/EEC EU Construction Produkt.

Tubat duhet të jenë të izoluar me një veshje me shumë elastomerike fleksibël me qeliza të mbyllura. Spesori i izolimit duhet të jetë 9 mm për instalim të brendshëm dhe 13 mm ose më i madh për instalim të jashtëm.



e- Elektroda saldimi për tub bakri

Elektrodat përdoren për procedurën e saldimit dhe janë të përgatitura prej materiali bakër me lidhje argjendi. Për saldimit të tubave të bakrit nevojitet gazoksi-acetilen që shërben për shkrirjen e elektrodave.



f- Gas R410A

Është gaz ekologjik i njohur edhe si AZ-20, përdoret gjerësisht për sistemin e kondicionimit. Nuk është toksik dhe jo i djegshëm.

Termoizolim izofleks me densitet të lartë, me adeziv dhe veshje alumini $\delta = 8$ mm

Rulona e termoizolimit janë termoizolues të nxehtësisë, ndalues dhe konservues të energjisë të bëra me teknologji të lartë.



g- Tubacionet e kondensatit.

Tubacionet e kondesatit shërbejnë për mbledhjen e ujit të kondesimit nga pajisjet e kondicionimit VRF. Ato duhet të jenë prej polipropileni me guarnicion dhe gominë. Diametri i tubave varion nga 25 mm deri në 40 mm në varësi të projektit.

Pjesët horizontale duhet të kenë pjerrësi jo më të vogël se 1.5%. Lidhja finale me rrjetin e shkarkimeve duhet të bëhet me sifon.

Polipropileni është një polimer pa ngjyrë, pa erë dhe gati transparent, me strukturë pjesërisht kristaline, që do të thote që mund të ngjyroset me një game shumë të madhe ngjyrash dhe të ketë një sipërfaqe të lëmuar dhe të shkëlqyeshme. Diferencohet nga aspektet e mëposhtme:

guarnicioni prej elastomeri, me buzë të dyfishtë, me permistop.

Pika zbutëse më të larta.

Rezistencë më të madhe nga temperaturat e larta.

Më rigjide dhe me i fortë

Rezistencë sipërfaqësore më të madhe ndaj gervishtjeve dhe abrazioneve.

h- Kablli i transmetimit.

Ky kabell përdoret për transmetimin (komandimin) midis pajisjeve të jashtme dhe pajisjeve të brendshme.

Kablli duhet të jetë konduktor fleksibël me bakër të kuq, veshur me PVC si shtresë mbrojtëse. Duhet të plotësojë standartet BT 2006/95/CE. Duhet të ketë 2 fije me seksion 07-12 mm². I pa skemuar.

i- Gazi Teknik për saldim dhe vënien në presion.

Këto gaze përdoren për procedura testimi dhe për saldimin e tubave. Normalisht për sistemet VRF përdoren bombola oksigjeni, azoti dhe acetileni me vlera presioni të caktuara.

j- Testimi i paisjeve

Të gjitha paisjet (furnizimi dhe kthimi) duhet të testohen dhe të jenë hermetike në mënyrë të tillë që i gjithë sistemi, duke përfshirë edhe lidhjet fleksibël me njësitë fundore, nuk duhet të kenë rrjedhje më shumë se 4% të sasisë maksimale projektuese të ajrit në presionin statik të projektuar.

Testimi duhet të bëhet me anë të paisjeve të aprovuara.

Paisjet të shoqërohen me katalogët përkatës ku të jenë të specifikuara të gjitha të dhënat teknike të prodhimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes si dhe të kenë certifikatë CE.

Në përfundim të çdo procesi pune, të hartohet proces verbali i tyre me supervizorin.

Në përfundim të punimeve të kryhet pastrimi i objektit.

Të gjitha punimet e parashikuara në preventiv do të zbatohen duke pasur parasysh KTZ në fuqi.

Për hartimin e situacionit do mbahen librezat e masave, ditaret, si dhe proces verbale për punime të maskuara (gjithë dokumentacioni konform legjislacionit në fuqi).

Sistemi ngrohje-ftohje të kete një garanci jo më pak se (5) pesë vjet.

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet :

Afatet e lëvrimit: **3 muaj**

Shtojca 11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

☐ Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]* është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

- tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktuesi” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intellektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashitë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron mallrat.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike

